



# **Rishikim i parashikimeve makroekonomike**

Anita Angelovska-Bezhoska,  
guvernator  
**nëntor, 2020**




# Pandemia e virusit korona ka qenë e pranishme më gjatë se pritjet fillestare

- **Bota ballafaqohet me krizën më të madhe ekonomike pas depresionit të madh:**
  - Bëhet fjalë për një krizë të sinkronizuar ekonomike e cila njëkohësisht i godet thuajse të gjithë ekonomitë në botë - pritet që vetëm rreth 26 vende të kenë një normë të vogël pozitive të rritjes ekonomike;
  - Bëhet fjalë për një krizë e cila ndryshe nga kriza e madhe ekonomike e vitit 2008 nuk është rezultat i bazave të dobëta ekonomike ose dobësive të sistemit financiar, por është një krizë shëndetësore e cila shpejt u transferua në sektorin real;
  - Masat/kufizimet që ishin të nevojshme për mbrojtjen e shëndetit, bashkë me pasigurinë e lartë dhe pritjet e përkeqësuar nënkuptonin kufizimin e ofertës dhe kërkesës, duke çuar në një rënie të ndjeshme të aktivitetit ekonomik;
  - Tregjet ndërkombëtare financiare gjithashtu reagues ndaj këtyre zhvillimeve në sektorin real, ku fillimisht pati një rritje të ndjeshme të kostos së financimit dhe qasje të kufizuara në financa, por falë reagimeve të bankave qendrore (të cilat, ndryshe nga kriza globale ishin më të shpejta dhe më të forta) pasoi stabilizimi;
  - Pritjet fillestare ishin që efekti më i madh negativ do të ndihej në tremujorin e dytë, pasuar nga një rimëkëmbje e shpejtë, por duke pasur parasysh valën e dytë të krizës, pavarësisht reagimeve të forta të krijuesve të politikave fiskale dhe monetare, është e qartë se rimëkëmbja do të jetë më e ngadaltë;
  - Një rrezik pozitiv për perspektivën ekonomike do të ishte shfaqja e një vaksine më herët se sa pritej, duke pasur parasysh përpjekjet e intensifikuara globale në atë fushë.




# FMN-ja ka kryer një rishikim në rënie për aktivitetin ekonomik global

- Për vitin 2020, parashikohet rënie e ekonomisë globale prej 4,4%, më e thellë krahasuar me vlerësimet e prillit (3%), me
  - një rënie më të shprehur në ekonomitë e zhvilluara krahasuar me ekonomitë në rritje;
  - efekt më të shprehur negativ mbi sektorin e shërbimeve sesa mbi sektorin e industrisë.
- Për vitin 2021, parashikohet rimëkëmbje e ekonomisë globale me një rritje prej 5,2%, mirëpo më e ngadaltë se sa në prill (5,8%) dhe me dinamikë të pabarabartë - rikuperim më i shpejtë në vendet në rritje (ritje prej 6%), dhe më të dobët në vendet e zhvilluara (ritje prej 3,9%);
- Supozime kryesore në plan afatmesëm - efekte afatgjata mbi potencialin e ekonomive, megjithëse pritet të zbuten përmes mbështetjes së mëtejshme fiskale dhe monetare dhe duke ruajtur kushte relativisht të favorshme financiare;
- Në rast të trajtimit më të ndaltë të pandemisë, do të pritej një rënie më e madhe për këtë dhe rritje më të dobët për vitin e ardhshëm.



\* Заради високата неизвесност во тековните глобални економски услови, во базата на податоци од Април 2020 година, проекциите се прикажани само до 2021.  
Извор: ММФ, Светски економски преглед.



Извор: Светски економски преглед на ММФ, октомври 2020.

# Kërkesë më pak të favorshme të huaj efektive


- Pritet që kërkesa e huaj për mallrat dhe shërbimet tona të ulet për 6,3% këtë vit (për industrinë kjo është rënia më e madhe që në vitin 2008), pastaj rritje në 2 vitet e ardhshme (4,6% dhe 3% në vitin 2021 dhe 2022, respektivisht), që paraqet një korigjim në rënie krahasuar me prillin për tërë periudhën e parashikimit (kur pritej një rënie prej 5% në vitin 2020 dhe rritje prej 4,9% dhe 1,9% në dy vitet e ardhshme).
- Korigjimi në rënie për këtë vit shpjegohet me pritjet më të dobëta në pothuajse të gjithë partnerët tonë më të rëndësishëm tregtarë, me kontribut më të madh të ekonomisë gjermane, e cila është partneri ynë më i rëndësishëm.
- Rreziqet rreth parashikimeve për rritje të kërkesës së huaj janë kryesisht në rënie (të kushtëzuara nga kohëzgjatja e pandemisë, masave për trajtimin e virusit, si dhe shpejtësisë së kthimit të besimit dhe stabilitetit të pritjeve).



Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.



Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.



Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.




# Ndikim nga mjedisi i jashtëm mbi kushtet për këmbim

## • Vazhdojnë pritjet për çmime të ulëta të importit:

- Rritje e vogël e inflacionit efektiv të huaj (normë rritjeje prej 0,5%, 1,4% dhe 1,7% për vitet 2020, 2021, 2022, respektivisht), pa ndryshim të madh krahasuar me prillin;
- Me një rënie të thellë të çmimeve botërore të naftës, mirëpo diçka më të vogël krahasuar me prillin, si pasojë e vazhimit të marrëveshjes së vendeve anëtare të OPEK+ për kufizimin e prodhimit, kur kërkesa globale është akoma e dobët;
- Çmimet e ushqimit janë të rishikuara për poshtë për vitin 2020 (me nivele rekorde të prodhimit të misrit dhe grurit), ndërsa për vitin 2021 rishikimet janë konsiderueshëm në rritje.
- Çmimet e eksportit njëjtë do të mbeten në nivel të ulët, mirëpo është pozitive që çmimet e metalit janë të rishikuara në rritje.


***Në përgjithësi, kjo tregon mungesën e presioneve më të mëdha mbi inflacionin dhe efekt më të favorshëm mbi importin dhe eksportin.***

**Странска ефективна инфлација**  
(годишни промени во %)




Извор: „Консензус форкаст“ и пресметки на НБРСМ.

**Цена на nafta "брент"**  
(во евра; годишни промени во %)



Извор: ММФ и пресметки на НБРСМ.

**Цени на метали**  
(во евра; годишни промени во %)



Извор: ММФ и пресметки на НБРСМ.



# Supozime për parashikimet për ekonominë maqedonase

- Në përgjithësi, mjedis i jashtëm më pak i favorshëm, gjegjësisht rënie më e shprehur e kërkesës së huaj për këtë vit dhe rimëkëmbje të moderuar në periudhën e ardhshme dyvjeçare, me një rimëkëmbje më të ngadalshme të eksportit.
- Pasiguri e rritur edhe nga mjedisi i brendshëm, me paraqitjen e valës së dytë të korona virusit, që pritet të ketë efekte të vazhduara ekonomik mbi konsumin dhe investimet private edhe në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm.
- Politikë më ekspansive fiskale për këtë vit, për shkak të mbrojtjes së shëndeti publik dhe zbutje të efekteve nga kriza, si dhe konsolidim më të moderuar fiskal në plan afatmesëm.
- Intensifikim i ciklit të investimeve publike infrastrukturore në dy vitet e ardhshme, pas ngadalësimit në këtë vit.
- Kapacitetet ekzistuese të orientuara kah eksporti, që janë pjesë e zinxhirit global të prodhimit, pas ngecjes në tremujorin e dytë, pritet se do të rrisin eksportin dhe do të çojnë në mbështetje të qëndrueshme kah eksporti dhe rritja.
- Ruajtje e kushteve të favorshme financiare si rezultat i politikës së relaksuar monetare.




# **Skenari makroekonomik për vitin 2020 - 2022**



# Parashikimi i PBB-së

- Duke pasur parasysh supozimet, kryejmë një rishikim në rënie të parashikimit për rritje të ekonomisë vendase në tërë periudhën e parashikimeve
- Për vitin 2020 parashikojmë rënie të aktivitetit ekonomik prej 4,9% (përkundër rënies prej 3,5% në prill) - performanca më të dobëta në gjysmën e parë të vitit dhe vlerësime për rimëkëmbje më të ngadaltë në gjysmën e dytë të vitit për shkak të valës së dytë të pandemisë.
- Në plan afatmesëm parashikojmë rimëkëmbje graduale por më të moderuara, me norma të rritjes prej 3,9%, 3,6% dhe 4% në vitet 2021, 2022 dhe 2023, respektivisht.
- **Kjo trajektore e rritjes nënkupton se ekonomia do të kthehet në nivelin e para krizës gjatë vitit 2022.**



Извор: Државен завод за статистика и пресметки на НБРСМ.





# Parashikimi i PBB-së


- **Rënie në të gjithë komponentët e PBB-së në vitin 2020, përveç në konsumin publik:**
  - Rënie më e madhe në investimet bruto - rënie prej 12,8% në kushte të IHD-ve të zvogëluara, si dhe investime më të dobëta vendore nga ana e sektorit privat dhe publik;
  - Konsum privat me një rënie prej rreth 4% në kushte të rënies së të ardhurave të disponueshme të popullatës, me zhvendosje të pafavorshme në tregun e punës dhe transferime më të ulëta private, dhe përmbajtje më e madhe nga konsumi;
  - Eksporti do të shënojë rënie prej 11,7% për shkak të kërkesës së zvogëluar të huaj dhe ngecjes së përkohshme të zinxhirëve globalë të furnizimit;
  - Konsumi i zvogëluar privat dhe investues, bashkë me rënien e eksportit do të çojnë në presione më të ulëta importuese, gjegjësisht importi do të ulet për rreth 12%.
  
- Nga viti 2021, rimëkëmbje me kontribut pozitiv e të gjithë komponentëve të rritjes në kushte të mjedisit më të favorshëm të brendshëm dhe jashtëm dhe pasiguri të zvogëluar, gjë që ka ndikim të favorshëm mbi vendimet për investim dhe konsum, që do të mbështetet edhe nga aktiviteti i qëndrueshëm i kredisë.
  
- **Sidoqoftë, rreziqet e rritjes mbeten kryesisht në rënie.**

	БДП	Лична потрошувачка		Бруто-инвестиции		Извоз на стоки и услуги		Увоз на стоки и услуги		Јавна потрошувачка		Домашна побар.	Нето-извоз
	%	%	п.п.	%	п.п.	%	п.п.	%	п.п.	%	п.п.	<i>придонес во п.п. (окт. 20)</i>	
2020	<b>-4.9</b>	-4.3	-3.3	-12.8	-4.2	-11.7	-8.3	-11.9	10.6	2.2	0.3	-7.2	2.3
2021	<b>3.9</b>	3.4	2.5	8.1	2.4	4.1	2.6	4.5	-3.7	0.8	0.1	5.0	-1.1
2022	<b>3.6</b>	3.3	2.3	9.1	2.7	6.1	3.9	5.7	-4.8	-3.8	-0.6	4.5	-0.9
<b>2021-2022</b>	<b>3.8</b>	<b>3.3</b>	<b>2.4</b>	<b>8.6</b>	<b>2.5</b>	<b>5.1</b>	<b>3.3</b>	<b>5.1</b>	<b>-4.3</b>	<b>-1.5</b>	<b>-0.2</b>	<b>4.8</b>	<b>-1.0</b>



# Parashikimi i inflacionit


- Trajektorja e parashikuar e rritjes ekonomike nuk do të krijojnë presione më të mëdha nga ana e kërkesës mbi inflacionin dhe rrjedhimisht presim se inflacioni, në plan afatmesëm do të mbahet në nivel të moderuar.
- Kështu, për vitin 2020, duke pasur parasysh devijimet pak më të larta për dhjetë muajt e këtij vitit (1%), kryejmë një rishikim të moderuar në rritje prej 0% në 1,1%, ndërsa për dy vitet e ardhshme i ruajmë parashikimet e njëjta prej 1,5% dhe 2%, respektivisht.
- Rreziqet për inflacionin e parashikuar janë kryesisht të lidhura me pasigurinë rreth çmimeve të importit të ushqimit dhe lëndëve djegëse (pjesëmarrje e konsiderueshme e shportës së konsumit), si dhe kufizime të mundshme të ofertës lidhur me pandeminë.





# Bilanci i pagesave - llogaria korrente -


- Pas deficitit të moderuar në llogarinë korrente në vitet e kaluara (mesatarisht 2% të PBB-së), këtë vit pritet zgjerim i deficitit në 3,7% të PBB-së - pak më i lartë se pritjet e prillit për deficit prej 3,2% të PBB-së.
  - zvogëlim i transferimeve private (ofertë më e ulët, veçanërisht për shkak të dërgesave më të ulëta jozyrtare nga jashtë, përkundër dërgesave më të larta përmes kanaleve zyrtare);
  - deficit pak më i lartë tregtar (deficit më i lartë joenergjent, ndërsa efekt pozitiv në saldon e energjentëve për shkak të rënies së lartë të çmimeve të energjentëve);
  - tepriçë më e lartë në shërbime (rregullim më i shprehur në rënie në import krahasuar me rregullimin në rënie në eksport dhe shërbime).
- **Në plan afatmesëm pritet ngushtim gradual i deficitit në llogarinë korrente: 2,6% të PBB-së në vitin 2021 (1,8% në prill) dhe deficit mesatar prej 1,6% të PBB-së në dy vitet e ardhshme.**





# Bilanci i pagesave - llogaria financiare -

- Hyrje neto në llogarinë financiare në vitin 2020-2021 prej mesatarisht 3,1% të PBB-së (ngjashëm si në prill), me ç'rast flukset financiare kryesore do të jenë IHD dhe huamarrja e qeverisë dhe sektorit privat.
- **Pritet që këto hyrje financiare të janë të mjaftueshme për financimin e deficitit të llogarisë korrente dhe të mundësojnë rritje të rezervave valutore në plan afatmesëm.**
- Gjatë tërë periudhës së parashikimeve, treguesit për mjaftueshëminë e rezervave valutore (raporti i rezervave me importin e parashikuar të mallrave dhe shërbimeve, me borxhin etj.) janë në zonë të sigurt.



# Rritja e depozitave dhe kredive

- Performancat e deritanishme tregojnë rritje të qëndrueshme të depozitave dhe kredive, që janë mbi pritjet e muajit prill - rritje vjetore në fund të tremujorit të tretë prej 5,4% dhe 7.3%, respektivisht.
- Rritja e qëndrueshme e bazës depozituese është rezultat i më shumë faktorëve, përfshirë edhe masave të zbatuara ekonomike për trajtimin e pasojave nga kriza shëndetësore, përmes të cilave u siguruan mjete shtesë për kompanitë dhe amvisëritë, si dhe përmbajtje nga shpenzimi/investimi gjatë pasigurisë.
- Rritja e qëndrueshme e aktivitetit të kredisë është rezultat i rritjes së qëndrueshme të depozitave si burim kryesor i financimit, politikës së lehtësuar monetare, ndryshimeve rregulatore dhe ristrukturimit të kredive, si dhe kreditë e favorshme nga Banka për Zhvillim.
- Duke pasur parasysh arritjet më të mira bëjmë një rishikim në rritje për vitin 2020 - rritje e depozitave prej 4,4% dhe rritje e kredive prej 5,3%, në bazë vjetore, më pastaj përshpejtim gradual me ç'rast rritja do të arrijë rreth 8%.

## Кредитен раст



## Депозитен раст





# Përmbledhje

- Vlerësimet e fundit për periudhën 2020-2023 tregojnë efekte të vazhduara nga pandemia, përkundër vlerësimeve të prillit për natyrë më afatshkurtër të krizës shëndetësore.
- Parashikimet për ekonominë vendase tregojnë rënie më të lartë këtë vit dhe rimëkëmbje më të moderuar në të ardhmen.
- **Për të zbutur efektet negative për sektorin real, në kushte të rezervave të qëndrueshme valutore dhe inflacionit të ulët, Banka Popullore ndërmerr më shumë masa:**
  - **Zvogëlim i normës bazë të interesit prej 0,75 pikë përqindjeje;**
  - **Lirimin e likuiditetit shtesë përmes zvogëlimit të shumës së bonove të bankës qendrore;**
  - **Aktivizimin e masës jokonvencionale me të cilat ulet detyrimi i bankave për rezervë të detyruar për kreditë të miratuara për sektorët e prekur;**
  - **Lehtësim i kornizës rregulluese me qëllim lehtësimin e pagesave nga huamarrësit.**
- **Masat e ndërmarra kontribuuan për ruajtjen e kushteve të favorshme financiare dhe aktivitet të qëndrueshëm kreditor.**
- Rreziqet për parashikimet vazhdojnë të jenë në rënie dhe janë pothuajse tërësisht të lidhura me pandeminë, edhe pse përparimi më i shpejtë në zhvillimin e vaksinës është një faktor pozitiv.
- Banka Popullore edhe në periudhën e ardhshme me kujdes do t'i përcjellë zhvillimet, si dhe ndryshmet në kushtet e brendshme dhe të jashtme, me qëllim rregullimin e duhur të politikës monetare.



***JU FALEMINDERIT PËR  
KUJDESIN.***